



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primijsencë Më/Dana: 13.12.2017			
Nr. i c. gant/ Org. broj	Numri/broj	Shitje/ Pitag	Vlera/ Vendnost
02	035/02	1001	



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr. 28/2008, neni 51 paragrafi 1 të Statutit të komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011 dhe kontratës nr. 556 të lidhur në mesë Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo, Komunës së Vitisë dhe Këshillit të Veprimit Rinore Lokal për projektin Aftësitë për Punësim Rural (APR), Kryetari i Komunës bie këtë:

## VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIARE NË SHUMË PREJ 8.360,50€ KËSHILLIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL NË VITI

### I.

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej **8.360.50€** me shkronja ( tetëmijë e treqind e gjashtdhjetë euro e pesëdhjetë cent), Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Viti, në emër të implementimit të pjesës së dytë të kontratës numër 556 e lidhur në mes të Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo, Komunës së Vitisë dhe Këshillit të Veprimit Rinor Lokal për projektin Aftësitë për Punësim Rural (APR).

### II.

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 nga kodi buxhetor 21 për subvencione dhe transfere i Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi transferohen në llogari të KVRL-së nga Viti .  
Obligohet kryetari i KVRL-së që të paraqes raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.


### III.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

### IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë

Kryetari i Komunës së Vitisë  
z. Sokol HALITI



### Vendimi u dorëzohet

1. K.V.R.L – Viti
2. Drejtorisë për Kulturë, rini dhe Sport
3. Zyrës së Thesarit dhe
4. Arkivit